

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Republika e sofizmave
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/26/republika-e-sofizmave/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:23:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:03:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	819fcfb742646746e1c305f5e9cd0187772a3a987f6af66879cddeac145c9a27
TEKSTI	d4b3ec3be4ced06711532b03048ec6a7cdee14f5a84e216031dc92df701b2a44
PAMJA	c47818fc2905597a614cf5c51e86ad36190f2bc387dfe4d808987f6dd687bcbb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	73abb3005f6d08a6fe9da7f946f5f6a2cf060054fdc82e6fe01ef5784de5f545
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	df7a3e632afe7e8acb9ac556f323199c5ae38613c8b46aabf6598ebdbd0b152a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/73abb3005f6d08a6fe9da7f946f5f6a2cf060054fdc82e6fe01ef5784de5f545>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Opinion

Republika e sofizmave

Si e përdori kryeministri Edi Rama paraburgimin e kryebashkiakut të Tiranës si argument për të vënë në pikëpyetje drejtësinë.



nga Vangjel Stamo

1 minute më parë

në Artikull kryesor, Opinion

Koha e leximit: 5 min lexim

AA

0



Erion Veliaj duke u shoqëruar në Gjykatën Kushtetuese | Foto: LSA

Vendimi i fundit i Gjykatës së Lartë, i cili la në fuqi masën e sigurisë "arrest me burg" për kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj, duhej të shënonte një moment reflektimi dhe kërkesë llogarie për mazhorancën qeverisëse.

Në vend të kësaj, opiniononi publik u përball me një nga shfaqjet më të pastra të hipokrizisë politike, përmes një deklarate publike të kryeministrit Edi Rama. Duke e cilësuar mbajtjen në qeli të Veliajt si një "kalvar unik në historinë e Europës demokratike" dhe duke u ankuar se Tirana mbeti sërish "pa kokë", Rama jo vetëm që sulmoi hapur vendimarrjen e organit më të lartë të drejtësisë, por shpërfaqti edhe një mentalitet të rrezikshëm politik – atë sipas të cilit "korrupsioni i zyrtarëve të lartë nuk përbën rrezikshmëri shoqërore".

Në vend që të vepronte sipas parimeve më minimale të ligjit dhe moralit publik – duke kërkuar zëvendësimin e menjëhershëm administrativ dhe distancimin total nga aferat korruptive, shefi i qeverisë zgjodhi rrugën e sofizmave juridikë dhe të retorikës mbrojtëse. Kjo qasje vërteton sërish se lidershipi politik në Shqipëri nuk e sheh korrupsionin masiv dhe endemik si një plagë që po shkatërron vendin, por si një "problem teknik" ose si një "eksperiment juridik" që pengon funksionimin e makinerisë së pushtetit.

Veliaj ndodhet në paraburgim prej shkurtit 2025, kur Gjykata e Posaçme, me kërkesë të SPAK-ut, caktoi ndaj tij masën "arrest në burg". Ai akuzohet nga SPAK për korrupsion pasiv, pastrim parash dhe shpërdorim detyre, duke pretenduar se ai dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar para dhe pasuri nga subjekte që kishin marrë fonde publike ose leje nga Bashkia e Tiranës, si dhe se në disa vendimarrje urbanistike kishte interesa pasurore të lidhura me familjen e tij. Kryetari i Bashkisë Tiranë i ka mohuar akuzat, duke pretenduar përmes mbrojtjes se SPAK nuk ka paraqitur prova konkrete për korrupsionin dhe pastrimin e parave dhe se procesi ndaj tij është shoqëruar me shkelje procedurale dhe cenim të të drejtave të mbrojtjes.

Masa "arrest në burg" u la në fuqi nga Apeli i Posaçëm dhe, fillimisht, edhe nga Gjykata e Lartë. Në maj 2026, Gjykata Kushtetuese pranoi pjesërisht ankimin e Veliajt, shfuqizoi vendimin e mëparshëm të Gjykatës së Lartë dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim. Më 15 shtator 2026, pas rishqyrtimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, la përsëri në fuqi vendimin e Apelit të Posaçëm dhe, rrjedhimisht, masën "arrest në burg".

Në deklaratën e tij, Edi Rama u shpreh se një milion banorë të Tiranës po vuajnë pasojat e një "eksperimenti të paparë e të padëgjuar juridik, social dhe ekonomik". Ky lloj formulimi është një fyerje e drejtpërdrejtë për inteligjencën e qytetarëve. Eksperimenti i vetëm i paparë në këtë vend nuk është puna e organeve të drejtësisë, që guxojnë të vënë pas hekurave një zyrtar të akuzuar, por modeli qeverisës ku paratë publike dhe taksat e qytetarëve avullojnë përmes skemave të mirëfillta të korrupsionit.

Republika e sofizmave

08:03 | 26/09/2026

Zgjidhen tre anëtarët e rinj gjyqtarë të KLGJ-së

20:07 | 25/09/2026

Organizatat e medias denoncojnë sjelljen e policisë ndaj gazetares së Citizens.al

15:12 | 25/09/2026

Mjedisorët dërgojnë në Kushtetuese vendimin që zhveshi nga mbrojtja Pishë Poro-Nartën

13:37 | 25/09/2026

Nga aleatë të SHBA-së në të pandehur: Pse Uashingtoni e mbështeti Gjykatën Speciale për Kosovën

11:34 | 25/09/2026

Futja e Ballkanit në Shengen: një zgjidhje me përfitime për Evropën

09:59 | 25/09/2026

Kur Gjykata e Lartë refuzon të lirojë një zyrtar të lartë, ajo e bën sepse vlerëson se ekzistojnë dyshime dhe rethana që justifikojnë vijimin e masës së sigurisë. Por për kryeministrin, "ende nuk është bërë e dukshme prova e rrezikshmërisë ekstreme". Sipas këtij standardi, vjedhja e miliona eurove, abuzimi me detyrën dhe pastrimi i parave në kurriz të qytetarëve nuk qenkan "rrezikshmëri e lartë". Rrezikshmëri, sipas këtij mentaliteti, përbëjnë vetëm krimet e rrugës, ndërsa krimi me jakë të bardhë – ai që zhvat të ardhmen e një brezi të tërë, duhet trajtuar me doreza mëndafshi dhe tolerancë kushtetuese.

Përdorimi i metaforës se Tirana po lëngon "me kokë të prerë" është shtylla kurrizore e hipokrizisë së Ramës. Ideja e qytetit apo shtetit si një trup politik është shumë e vjetër. Në mendimin klasik dhe sidomos atë mesjetar, shoqëria përfytyrohej si trup, ndërsa sundimtari si koka që drejton gjymtyrët. Pa kokën, trupi humb drejtimin. Kur Rama thotë se Tirana jeton "me kokë të prerë", Veliaj shndërrohet metaforikisht në kokën e qytetit dhe bashkia në trupin që nuk funksionon dot pa të.

Në një demokraci moderne, kryetari nuk është koka biologjike pa të cilën institucioni vdes. Bashkia ka administratë, nënkryetarë, këshill bashkiak dhe kompetenca që duhet të vazhdojnë të funksionojnë përtej fatit personal të drejtuesit. Nëse një institucion kaq i madh mbetet "pa kokë" sapo kryetari nuk mund të hyjë në zyrë, atëherë problemi nuk është vetëm masa e sigurisë. Është modeli i qeverisjes.

Kush dëshiron ta kuptojë situatën dhe të marrë pjesë aktive për ta përmirësuar atë, e sheh qartë hendekun e madh mes propagandës qeveritare dhe realitetit. Kur ligji thotë se askush nuk është mbi shtetin, kryeministri mbron idenë se vota popullore e shndërrohet individin në një qenie të paprekshme, pavarësisht faturës penale që ai mbart.

Pyetja lind natyrshëm, pse kryeministri zgjedh të bëjë avokatin politik të një personi të zhytur në akuza për korrupsion? Përgjigjja lidhet me vetë natyrën e sistemit që ai ka ndërtuar. Korrupsioni në këtë administratë nuk paraqitet më si një rast i izoluar apo si një "mollë e kalbur" që ra rastësisht nga pema, por si një fenomen i përhapur, kapilar dhe endemik. Kur pushteti funksionon si një organizëm i vetëm, rënia e njëres prej "kokave" kryesore rrezikon të tronditë të gjithë strukturën.

Nga inceneratorët te tenderat e rrugëve, nga aferat e bashkive te postet ministrore, çështjet penale dhe akuzat për korrupsion janë ndërthurur aq fort me njerëz të afërt me mazhorancën, sa distancimi i prerë politik bëhet gjithnjë e më i vështirë. Në këtë këndvështrim, sulmi i tërthortë ndaj Gjykatës së Lartë mund të lexohet edhe si një mesazh politik për të gjithë sistemin: se pushteti do të vazhdojë t'i paraqesë proceset penale ndaj njerëzve të tij si "kalvare" apo "eksperimente" sa herë që drejtësia prek rrethin e afërt të mazhorancës.

Edhe formula e kryeministrit se "respekton drejtësinë, por nuk pranon metodat" mbart një kontradiktë të dukshme. Nga njëra anë, Rama krenohet me Reformën në Drejtësi dhe e paraqet atë si një prej arritjeve kryesore të qeverisjes së tij; nga ana tjetër, kur institucionet e kësaj drejtësie prekin njerëz të fuqishëm pranë pushtetit, gjuha ndryshon dhe proceset përshkruhen si "kalvare" apo "eksperimente të paparë juridike".

Deklarata e kryeministrit pas vendimit të Gjykatës së Lartë do të mbetet në histori si dokumenti zyrtar i amnistisë morale që ky pushtet i bën korrupsionit. Ajo provon se për këtë elitë politike, pushteti dhe zyrat janë pronë private që nuk mund të cënohen nga ligji i thjeshtë që vlen për te vdekshmit e zakonshëm të këtij vendi.

Tirana nuk është pa kokë sepse Erion Veliaj ndodhet në qelinë ku e ka vendosur ligji. Shqipëria dhe Tirana po vuajnë sepse u qeverisën për vite me radhë nga njerëz që moralin e zëvendësuan me sofizma, dhe ligjin e kthyen në një llastik që shtrihet vetëm për të mbrojtur rrethin e të paprekshmëve.

Demaskimi i kësaj hipokrizie nuk është më thjesht një çështje analize politike, por një emergjencë kombëtare për këdo që beson se ky vend meriton të qeveriset me dinjitet dhe jo me skenare qelish e propaganda mashtruese.

Me profesion arkitekt, Vangjel Petro Stamo ka qenë deputet i Partisë Demokratike në legjislaturën e parë pluraliste, nga 15 prill 1991 deri më 4 shkurt 1992, i zgjedhur në rrethin e Durrësit.

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Kreut nesh
Stafi
Kontaktimi
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe
rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN

Dev by [Slida.PRO](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.